



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Mbledhja nr.81/2016

Prishtinë, më 06.12.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,**  
**INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Muhamet Mustafa, kryetar, Glauk Konjufca, zëvendëskryetar, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rrustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar, Besim Beqaj dhe Sala Berisha – Shala – anëtarë.

**I ftuar:** Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Rexhep Bllaca, Shqipe Jashari – Sekiraqa dhe Elvis Feka nga MTI, Fjolla Uka – KDI, Dardan Abazi – INDEP dhe Etleva Malushaj – LVV.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Veton Raci.

**Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky:**

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes mbajtur më 29.11.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-130 për Shërbime;
4. Të ndryshme.

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.11.2016**

*Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 29.11.2016, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-130 për Shërbime**

**Kryetari** tha se sot kemi në shqyrtim para leximit të parë Projektligjin për Shërbime, që është sponsorizuar nga Ministria e Tregtisë dhe industrisë, andaj, në emër të ministrisë kemi zëvendës ministrin z. Kastrati për ta arsyetuar para Komisionit projektligjin, të cilit ia dha fjalën.

**Avni Kastrati, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë**, tha më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projekti legjislativ shkurtimisht të paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për Shërbime. Bazuar në nevojën për modernizimin e sektorit të shërbimeve në Kosovë me qëllim të fuqizimit të sektorit të shërbimeve në Kosovë për të nxitur zhvillimin ekonomik duke eliminuar barrierat ligjore dhe administrative për ofruesit e shërbimeve, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht Departamenti i Tregtisë ka propozuar hartimin e Ligjit për Shërbime. Arsyeshmëria për hartimin e Ligjit për Shërbime është se me këtë ligj përcaktohen parimet themelore dhe kriteret që mundësojnë të drejtën e themelimit dhe ushtrimit të aktivitetit për ofruesit e shërbimeve në Republikën e Kosovës, duke garantuar cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre. Ky ligj ndihmon në eliminimin e barrierave ligjore dhe administrative për ofruesit e shërbimeve, do të plotësojë edhe një standard i kërkuar nga BE dhe do të eliminojë edhe një pengesë për integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, e gjithashtu liberalizohet tregu në fushën e shërbimeve edhe me vendet e rajonit. Thjeshtësimi i masave që parashihen në këtë ligj do ta bëjnë jetën dukshëm më të lehtë për ofruesit e shërbimeve dhe do të rrisin transparencën e bizneseve dhe konsumatorëve kur ata ofrojnë ose përdorin një shërbim. Rezultati kryesor i arritur me miratimin e këtij ligji pos kompletimit të legjislacionit të sferës së shërbimeve në Kosovë dhe plotësimit të njëjës prej kërkesave të procesit të integrimi evropiane, përmes këtij Ligji ka vetëm përfitime nga ana e të gjitha institucioneve shtetërore, ekonomisë dhe qytetarëve, sepse do të ketë shumëllojshmëri të shërbimeve, ku konkurrenca dhe cilësia do të vinin në shprehje. Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Kosovës, është pranuar Deklarata Financiare nga Ministria e Financave dhe Opinioni i Pajtueshmërisë me Legjislacionin e BE-së nga MIE, se projektligji i lartpërmendur është i harmonizuar me Acquis-in e BE-së. Të gjitha këto veprime legjislative duhet të ndërmerren në mënyrë të përmbushen obligimet e Republikës së Kosovës të parapara me MSA. Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji në fushën e shërbimeve, ju propozoj që ta shqyrtoni dhe miratoni këtë Projektligj.

**Kryetari** tha se e shoh një rëndësi të këtij ligji ne aspektin e përmbushjes së legjislacionit dhe standardeve ndërkombëtare. Ky ligj ofron mundësi për përfituesit, por edhe për të gjithë ata që dëshirojnë të hyjnë në treg me ndonjë produkt të ri. Ajo që kam vërejtur në këtë projektligj është fakti se me këtë projektligj përjashtohen aq shumë shërbime saqë sipas mendimit tim me lehtë do të ishte të ceken cilat shërbime i rregullon ky ligj, se sa cilat i përjashton. Kurse dilema e dytë ka të bëjë me faktin se kërkohen 5 (pesë) vjet për harmonizim, ose më ligjet që i rregullojnë shërbimet e veçanta, nuk e di se a është ky afat i arsyeshëm ndoshta edhe ka arsye pse është kështu, por ndoshta ka mundur të jetë edhe me i shkurtër, por besoj se do të marrim sqarime shtesë.

**Blerim Grainca** tha së është ligj i domosdoshëm për kohën dhe trendin e zhvillimeve në të cilat po jetojmë, por edhe unë kam disa vërejtje, ka një numër të madh të sektorëve që ky ligj nuk i rregullon, siç janë shërbimet financiare, shërbimet sociale, shërbimet e transportit dhe telekomunikimit, shtrohet pyetja se çfarë rregullon ky ligj, pasi mbesin jashtë gjithë këto fusha. Po ashtu, në nenin 14 kam një vërejtje dhe kërkoi sqarime shtesë lidhur me “Pikën e vetme të kontaktit” sepse e kam të paqartë, a është portal i Qeverisë apo çka? Gjithashtu flitet edhe për disa autorizime të veçanta, ku edhe këtu kërkoi sqarime.

**Glauk Konjufca** tha se ka dy probleme me përmbajtjen e këtij ligji, e para ka të bëjë me kuptimin e mbulueshmërisë, do të ishte mirë që të behet një analizë e saktë se ku kemi mbulueshmëri aktuale ligjore dhe cilat fusha kanë mbetur të pambuluara nga ky ligj. Kurse vërejtja e dytë është ne nuk kemi raport të strukturës së shërbimeve në Kosovë. Andaj neve na duhet informim shtesë që të jemi me të qartë dhe kërkoi nga ju që të kemi një raport lidhur me kontekstin. Pra, kërkoi nga Qeveria të mos na vijë ligji vetëm me përmbajtje, por është shumë më e rëndësishme që ne ta kemi një analizë me të saktë të gjendjes ekzistuese të fushës të cilën e rregullon ligji i caktuar, të ketë konsultim me grupe të interesit. Sepse kur ne e gërshetojmë kontekstin me ligjin dhe të njohim më mirë fushën, mund ta kuptojmë me lehtë se ku janë defektet e këtij ligji në fjalë, ku çalon, ku duhet të jetë më i mirë, sepse na ndihmon shumë edhe gjatë fazës së amendamentimit në Komision.

**Raif Qela** tha se para nesh e kemi edhe një projektligj i sponsoruar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, aq sa e pashë unë mendoj së është një projektligj i punuar me më shumë kujdes se sa projektligjet që i kemi pasur kohën e fundit. Mendoj se në përgjithësi nuk ka vërejtjet përmbajtjesore që do ish dashur t’i themi tani, nëse eventualisht ka, ato do mund të korrigjohen në ndërkohë. Vërejtjet që i dhanë parafolësit e mi lidhur me fushat të cilat nuk i përfshin ky projektligj, mendoj se këto përjashtime që janë bërë janë të arsyeshme, për arsyen sepse këto fusha janë të mbuluara me ligje të tjera dhe nuk ka pasur nevojë që të ndërhyhet edhe në fusha të tjera. Po problem tjetër është se ajo se a të specifikohet se cilat fusha i përfshin apo cilat fusha nuk i përfshin ky projektligj, edhe mendoj se ka bërë mirë se fushat e tjera p. sh. të komunikimeve, të gjitha ato fusha që janë përmend këtu si përjashtime prej këtij projektligji, janë të rregulluara me ligje të tjera. Propozimin që e dha deputeti Konjufca, lidhur me atë që ne do ishte dashur të njihemi me rrethanat konkrete në mënyrë që të kemi edhe pasqyrë më të qartë për projektligjin, mendoj që këto, si çështje mund t’i trajtojmë këto si çështje në procedurën e mëtutjeshme, sidomos në debatin publik edhe nëse e shohim se kemi nevojë për informata shtesë që d.m.th. që të mos ndalemi këtu ta miratojmë sot në parim dhe të vazhdojmë më tutje, po edhe në qoftë se do

shkojmë me informacione shtesë të kërkojmë qoftë prej palëve të interesit që do të jenë këtu të pranishme në debat publik apo edhe më vonë.

**Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë**, këtë projektligj e kanë punuar një ekip nga BE-ja, por nuk do të thotë që nëse e kanë punuar ata se ne nuk mund të bëjmë më mirë se sa që është. Sa i përket pjesës së shumë gjëra nuk janë të përfshira me këtë ligj, në deklaratën e përputhshmërisë se legjislacionit me “Acquis” të BE-së, në nenin 4.4 thuhet se dispozitat e kësaj Direktive në Ligjin për Shërbimet janë transpozuar pjesërisht, pasi që Kosova nuk është anëtare e BE-së, kjo nënkupton se autoritetet e Kosovës kanë një liri të mjaftueshme të diskrecionit gjatë vënies së Direktivës së shërbimeve në legjislacionin e vet. Arsyet për mospërputhje është sepse harmonizimi i plotë i kësaj Direktive mbetet të arrihet në një të ardhme prej 5 (pesë) vjetëve në bashkëpunim të plotë me institucionet e përfshira në shërbime. Deputeti Konjufca ngriti çështjen e konsultimit me grupet e interesit. Ne iu kemi dërguar pyetësorin dhe kemi vepruar ashtu siç duhet edhe tek Oda Ekonomike, Asociacioni i Komunave etj. por fatkeqësia e madhe është se ne nuk kemi marr asnjë koment. Jam mirënjohës se me ndihmesën, angazhimit tuaj sigurisht që do të vihet një ligj me kualitativ sepse Kosova ka nevojë edhe për shërbimet e huaja, por edhe ofrimin e shërbimeve tona jashtë shtetit.

**Rexhep Bllaca, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**, tha sa i përket çështjes së rregullimit të shërbimeve prapë shërbimet do të rregullohen me ligje të veçanta, ndërsa nëse e shohim nenin 1 të këtij ligji shohim se qëllimi i tij është që të rregullojë vetëm parimet dhe kriteret themelore të cilat do të mbulohen nga të gjitha shërbimet të cilat rregullohen me ligje të veçanta. Sa i përket fushëveprimin të këtij projektligji gjer me tani ne kemi identifikuar 80 shërbime në fushën e sektorit privat që mbulohen me këtë ligj dhe janë identifikuar 123 akte nënligjore që duhet të ndryshohen dhe mu për këtë arsye ne e kemi lënë një afat prej 5 (pesë) vjetëve. Më këtë ligj do të rregullohen vetëm shërbimet e pastra të sektorit privat, siç janë shërbimet turistike, avokatisë, kontabilitetit, gjuetisë, arkitekturës, ndërtimtarisë d.m.th. këto që prekin lëvizjen e lirë të personave në sektorin privat. Sa i përket “Pikës së vetme të kontaktit” neni 14, do të jetë një portal qeveritar për fillim, pra një data bazë ku do të publikohen të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë shërbimet, ka qenë edhe rekomandim i Bankës Botërore, por edhe i BE-së që të themelohet një ueb- faqe ose një njësi apo një dritare e vetme ku do të ketë qasje për informacion.

**Kryetari** tha se nga ky ligj konsideroj që tregu ynë i hapet konkurrencës së shërbimeve dhe kjo është esenca e këtij ligji, d.m.th. nuk ka diskriminim dhe kjo i kontribuon edhe cilësisë. Gjithashtu duhet të kemi parasysh mbrojtjen e shërbimeve dhe prodhimeve vendore, mendoj se duhet të parashihet në ligj.

**Rrustem Berisha** tha se afati për rregullimin e akteve nënligjore, u tha se është 5 (pesë) vjet, ndërsa te neni 29, thuhet se është një vit nga dita e hyrjes në fuqi, tani a do të jetë 5 (pesë) vjet apo 1 (një) vit?

**Kryetari** tha se edhe unë po mendoj se kur bartet nga një qeverisje në qeverisjen tjetër i bie që është shumë të jetë ky afat prej 5 vjetëve, por do të shqyrtohet.

**Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë,** për deputetin Grainca, neni 14.4 thotë se mënyra e funksionimit të “pikës së kontaktit” thotë se rregullohet me akt të veçantë nënligjor të miratuar nga Qeveria e Kosovës.

**Kryetari** tha se këtë portal e shoh të rëndësishëm sepse për përfituesin e shërbimeve mund t’i marrin të gjitha informacionet aty edhe ata që dëshirojnë të ofrojnë shërbime mund të informohen për konkurrencën.

**Rexhep Bllaca, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,** sqaroi se sa i përket afatit 5 vjeçar, përveç mundësisë së nxjerrjes së akteve nënligjore ekziston edhe mundësia që me hyrjen e këtij ligji në fuqi. Ligji i avokatisë e ndalon që avokatet e huaj të themelojnë direkt zyre të tyre në vendin tonë, pra më këtë hapësirë e mbron shërbimin tonë.

**Kryetari,** lidhur më propozimin e deputetit Konjufca, mendoj se kishte të drejtë, por ne nuk mundemi që me këtë ligj ta bëjmë këtë ndryshim në memorandum shpjegues. Ndoshta si Komision mund ta kërkojmë këtë si standard që kur të na vijë projektligjet, ne memorandum shpjegues konteksti të jetë më mirë i shpjeguar. Unë plotësisht e përkrah këtë kërkesë dhe ne, si Komision, mund t’ia dërgojmë këtë kërkesë Kryesisë së Kuvendit apo Qeverisë dhe të gjejmë rrugëdalje, sepse më të vërtetë do t’i kontribuonte një debati me cilësorë në Komision dhe kjo nuk do të jetë problem sepse çdo ministri e njeh kontekstin.

*Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:*

#### *Përfundim*

*1. Miratohet në parim Projektligjit nr.05/L-130 për Shërbime.*

*2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.05/L-130 për Shërbime.*

*Komisioni vendosi që grupi i punës për shqyrtimin e këtij projektligji, të jetë me këtë përbërje: Rustem Berisha, kryesues, Glauk Konjufca dhe Blerim Grainca.*

#### **4. Të ndryshme Çështjet vijuese**

Kryetari i njoftoi deputetët se sot prej orës 13:00, siç edhe janë njoftuar do të mbahet një takim me përfaqësues të Bankës Botërore, më kërkesë të tyre.

**Mbledhja përfundoi në ora 12.00.**

**E përgatiti:  
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetar i Komisionit,**

-----  
**Muhamet Mustafa**